



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES

Nr. 276/prot.  
11

Tiranë, më 14.04.2026

**VENDIM**

Nr. 33, datë 14.04.2026

**PËR**

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË  
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 12, DATË 9.2.2026**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, dhe Rregulloren, "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, (e ndryshuar), pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit të Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese dhe Koordinimit, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit nr. 12, datë 9.2.2026, të Komisionerit, "Mbi përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë, në lidhje me veprimet administrative të kryera gjatë procesit të ecurisë disiplinore, në institucionin e Bashkisë Tiranë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar paligjshmërinë e konstatuar",

**KONSTATOVA SE:**

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është regjistruar informacioni me shkresën nr. 1168 prot., datë 24.12.2025, nëpërmjet të cilit nëpunësi Altin Bllako, me detyrë "Specialist i Informimit Qytetar", pranë Njesisë Administrative Nr. 8, Bashkia Tiranë, ka paraqitur pretendime për parregullsi në zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil gjatë procedurës së dhënies së masës disiplinore "Vërejtje" ndaj tij.

Për verifikimin e informacionit, bazuar në nenin 16, Kreu III "Procedura paraprake", të Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, ndryshuar me vendimin nr. 158, datë 30.12.2022, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është nisur hetimi administrativ.

Për këtë qëllim, Komisioneri i ka kërkuar institucionit, Njesisë Administrative Nr. 8, Bashkia Tiranë, vënien në dispozicion të të gjithë dokumentacionin që provon veprimet administrative të kryera.

Njëkohësisht, vërehet se në të njëjtin akt, është urdhëruar eliminimi i pasojave të aktit për dhënien e masës disiplinore, duke e hequr atë nga dosja personale e nëpunësit dhe Regjistri Qendror i Personelit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

### PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" dhe Rregulloren, "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, (e ndryshuar), dhe në mbështetje të analizës së mësipërme mbi përmbushjen e detyrimeve nga institucioni,

### VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit nr. 12, datë 9.2.2026, të Komisionerit, "Mbi përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë, në lidhje me veprimet administrative të kryera gjatë procesit të ecurisë disiplinore, në institucionin e Bashkisë Tiranë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar paligjshmërinë e konstatuar".
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e Njesisë Administrative Nr. 8, Bashkia Tiranë duke përmbushur detyrimet e përcaktuara në dispozitivin e Vendimit nr. 12, datë 9.2.2026.
3. Njoftimin e këtij vendimi Njesisë Administrative Nr. 8 dhe për dijeni Bashkisë Tiranë. Njësia Administrative Nr. 8, të marrë masa për njoftimin e këtij vendimi nëpunësit Altin Bllako.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

